VENDIM
Nr. 530, datë 25.7.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 460, DATË 3.7.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2019, MIRATUAR PËR MINISTRINË E DREJTËSISË, AGJENCINË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT DHE MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 460, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën "b", të pikës 2, shifra 199 000 000 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë) lekë bëhet 238 800 000 (dyqind e tridhjetë e tetë milionë e tetëqind mijë) lekë.

b) Pas pikës 2, shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

"2.1 Me fondet e vëna në dispozicion, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të zhvillojnë procedurat e prokurimit dhe të lidhin kontratat përkatëse për realizimin e projekteve të përmendura në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama